



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 397/22
409/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-04, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Kimete Gashi – Kryetare; Nita Bejta- Anëtare; Vedat Poterqoi- Anëtar; Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik "Pharma Lider LLC" Prishtinë dhe Operatori Ekonomik "Meditech" ShPK Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Insulina analoge nga Lista Esenciale" Lot 1 dhe 3, me Nr. te prokurimit 206- 20-8397-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 11 tetor 2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Pharma Lider LLC" e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 26 Gusht 2022, numër protokollit 397/2022, për aktivitetin e prokurimit lidhur me tenderin: "Furnizim me Insulina analoge nga Lista Esenciale" Lot 1 dhe 3, me nr. te prokurimit: 206- 20-8397-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues;
2. Refuzohet si e palejuar për shqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik "Meditech" ShPK Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 29 Gusht 2022, numër protokollit 409/22, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Insulina analoge nga Lista Esenciale" Lot 1 dhe 3, me nr. te prokurimit: 206- 20-8397-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues;

3. Anulohet Vendimi i datës 12.08.2022 për anulim të aktivitetit të prokurimit ashtu që ky aktivitet i prokurimit kthehet në Rivlerësim dhe obligohet Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, që ri-vlerësoj ofertat, përkitazi me aktivitetin “Furnizim me Insulina analoge nga Lista Esenciale” Lot 1 dhe 3, me Nr. te prokurimit: 206- 20-8397-1-1-1;

4. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi;

5. OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092;

6. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës për OE “Pharma Lider LLC” dhe për OE “Meditech”, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP, kurse OE i cituar ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën konfiskohet depozitës dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

8. Shqiptohet gjoba në të holla për Autoritetin Kontraktues në lartësi të shumë 5.000,00 €, për shkak të mosrespektimit të Vendimit të OSHP të datës 25.03.2021, në pajtim me nenin 131, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;

9. Inicohet procedura për revokimin e certifikatës së prokurimit kundër zyrtarit përgjegjës të prokurimit të AK, për shkak të shkeljeve të dispozitës së nenit 25, paragrafi 8, të LPP;

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 12.12.2020, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar (numër, datë dhe emërtim) si në hyrje të këtij Vendimi, përderisa hapjen publike të ofertave e ka bërë me 05.01.2021.

Me 22.02.2021, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Vendimin e tij, sipas të cilit:

- “Pharma Leader” LLC është OE i rekomanduar për kontratë për Llot I me vlerën e ofertës 1,097,467.36 E dhe Lot III, me vlerën e ofertës 4,109,006.12 E. Kurse,
- “Meditech” OE i rekomanduar për kontratë për Lot II, me vlerën e ofertës 913,315.00 E

Me 26.02.2021, OE “Meditech” ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim, e cila është aprovuar me Vendimin e AK të datës 01.03.2021, kurse aktiviteti i prokurimit është kthyer në rishqyrtim.

Me 05.03.2021, AK ka marrë Vendim, sipas të cilit:

- OE "Meditech" është rekomanduar edhe për Lot I me çmim 1,114,726.72 €
- Dhe Lot III, me çmim 4,456,908.24 €.

Sipas këtij Vendimi, nënkuptohet se, OE "Meditech" tani është OE i vetëm i rekomanduar për të 3/tri lotet e këtij aktivitetit të prokurimit.

Me 10.03.2021, OE "Pharam Leader" LLC, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 12.03.2021. Kundër këtij Vendimi, OE në rastin konkret ka parashtruar Ankesë në OSHP me 15.03.2021.

Me 25.03.2021, OSHP kishte marrë Vendim (Nr. 240/21) sipas të cilit është anuluar Njoftimi për dhënie të kontratës për Lot I dhe III, kurse aktiviteti i prokurimit është kthyer në Rivlerësim.

Me 27.04.2021, (publikuar me 28.04.2021) duke vendosur në procedurën e rivlerësimit, AK ka marrë Vendim sipas të cilit për kontratë e ka rekomanduar OE "Meditech".

Me 30.04.2021, OE "Pharam Leader" LLC ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK me Vendimin e datës 06.05.2021.

Me 11.05.2021, kundër Vendimit të cituar si më sipër të AK, OE "Pharam Leader" LLC ka parashtruar ankesë në OSHP.

Duke vendosur lidhur me Ankesën, OSHP kishte angazhuar ekspertin shqyrtues që sipas autorizimeve të tija, të parapara me nenin 113 dhe 114 të LPP, ta bëjë vlerësimin paraprak të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Në këtë, sipas vlerësimit preliminar të ekspertit, pretendimet ankimore të OE "Pharam Leader" LLC, janë konsideruar të bazuara. Mirëpo, procedura ankimore në rastin konkret nuk ishte mbyllur me akt përfundimtar administrativ (vendim), meqë Bordit të OSHP (në përbërjen paraprake), i kishte skaduar mandati në kuptim të nenit 100, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Me 23.06.2022, Kuvendi i Kosovës ka emëruar Bordin e këtij Institucioni, dhe i njëjti me datën 12.07.2022, OSHP ka marrë Vendimin Nr. 397/21, sipas të cilit ankesa e OE (së bashku me një numër sosh) është hudhur si e palejuar për shqyrtim.

Me 12.08.2022, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, kundër të cilit me 16.08.2022, "Pharma Leader" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Po ashtu edhe OE "Meditech" me 17.08.2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Të dy Kërkesat e cituara si më sipër, janë refuzuar nga AK me Vendimin e datës 02.09.2022 si të pabazuara, kurse Vendimi për anulim e aktivitetit të prokurimit, ka mbetur në fuqi.

Kundër Vendimit të cituar si më sipër të AK, OE “Pharma Leader” ka parashtruar Ankesë në OSHP me 26.08.2022 (Protokolli 397), kurse me 29.08.2022 ka ushtruar Ankesë po ashtu edhe OE “Meditech“ (Protokolli Nr. 409/22).

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

OSHP, konsideron se Ankesat e OE janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtojë ankesë në OSHP. Meqë OE kanë ushtruar kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen njëherësh dhe nenit 108/A, meqë sipas paragrafit 1, të nenit 109, parashihet se, cituar: “Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji”. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara lidhur me nenin 111, dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkuara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit në pajtim me nenin 111, paragrafi 5, të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 dhe 114 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, Eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me 15.09.2022, me rekomandimet si në vijim:

- Të aprovohen si të bazuara ankesat e OE;
- Të anulohet Njoftimi AK i datës 12.08.2002 për anulimin e aktivitetit të prokurimit;
- Lënda të kthehet në rivlerësim;

- Seanca publike me palë –

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe ka konvokuar seancën e shqyrtimit kryesor me 03.10.2022, me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes. Pohimet e palëve, provat e administruara dhe shpjegimet e ekspertit janë evidentuar në procesverbalin e kësaj seance, të cilat në këtë rast për nevojat e këtij vendimi prezantohen (shkurtime) sikurse vijon:

1. Pohimet ankimore të OE “Pharma Leader”

OE “Pharma Leader” ka deklaruar se, qëndron prapa ankesës dhe pretendimeve ankimore duke kërkuar që Vendimi i datës 25.03.2021, Nr. 240-21, i OSHP të mbetet në fuqi, arsyetimin se:

1.1. Tentativa e AK për anulim të Lotit 1 dhe 3, është kontradiktore me vlerësimin e ofertave nga komisioni i parë i vlerësimit i këtij AK, të datës 08.02.2021 dhe Njoftimit mbi vendimin e datës 22.02.2021, të cilat janë të konfirmuar me Vendimin e OSHP me Nr. 240-21, të datës 25.03.2021, sipas të cilit është konstatuar se OE “Pharma Leader” ka prezantuar ofertë të përgjegjshme në përputhje me kërkesat e FDT dhe me çmimin me të lirë për 400.000,00 €.

1.2. Duke e shfrytëzuar vakumin institucional (*PSH nënkupto*: Mungesën e Bordit të OSHP), AK nuk e ka përfillur Vendimin e OSHP, cituar më sipër dhe përveç tjerash ka nënshkruar marrëveshje me UNOPS për Furnizim me Insulina Analoge, duke udhëzuar të njëjtin ta përjashtojë aplikimin e UA Nr. 02/2014, me qëllim që të eliminohet konkurrenca në dobi të një OE. Dhe si rrjedhojë, produktet medicinale në disa procese tenderuese janë blerë më çmime të shtrenjta se nga kompanitë vendore. Pas presionit nga opinioni publik, AK nuk e ka vazhduar kontratën me UNOPS, por megjithatë me 23.03.2022, ka shpallur njoftimin për tender të ri, në numër të prokurimit 206-22-2211-1-1-1, për të njëjtin qëllim të prokurimit, duke e përjashtuar nga kushtet sërish aplikimin e UA 02/2014. Në këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me Vendimin e cituar të OSHP dhe ka aplikuar blerje direkte me negociim, me çmime me te larta se OE “Pharma Leader”.

1.3. Kërkesa për ri-shqyrtim e OE “Meditech” është dorëzuar jashtë afatit ligjor të paraparë me paragrafin 3, lidhur me paragrafët 8. dhe 8.1, të nenit 108/A, të LPP. Në kundërshtim me dispozitat e cituara, AK e ka pranuar kërkesën si të afatshme, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e cituara të LPP dhe Udhëzimet e KRPP.

1.4. Duke vepruar në kundërshtim po ashtu dhe me sqarimet e Agjencionit Kosovar për Produkte dhe Pajisje dhe Medicinale (AKPPM), AK ka përdorur një Opinion, të një personi jo kompetent, duke shkaktuar konfuzione në interpretimin e Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale, të cilin zyrtaret e AK e përdorin si pretekst për shmangje nga UA 2/2014 dhe për ti ikur përgjegjësisë për veprimet e tyre, me të cilat kanë dëmtuar buxhetin e AK me 400,000.00 €, meqë për këtë shumë oferta e OE “Pharma Leader” është me e lirë.

1.5. Me tej OE “Pharma Leader” ka thkesuar se, OSHP me Vendimin Nr. 200/19, datë 11.06.2019, kishte lënë në fuqi vendimin e AK-MSH edhe përkundër faktit se produkti nuk kishte qenë i regjistruar me Autorizim Marketingu, kurse UA 02/2014, nuk kishte qenë pjesë e kërkesave të kualifikimit në FDT. Nga ky aspekt, AK është kontradiktor sepse:

- i. Lidhur me rastin e cituar si më sipër, AK ka kërkuar shpjegime nga AKPPM sipas të cilit produkti në fjalë është i regjistruar në tregun e BE dhe se mund të përdoret në treg të Kosovës;
- ii. Kurse, në këtë rast AK nuk e ka përfillur shpjegimin e AKPPM sipas të cilit: Lejohet furnizimi me insulina analoge sipas UA 2/2014, siç evidentohet edhe në Dosjen e tenderit “*Autorizim Marketing, me specifikim in e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele te regjistruar ne Kosove, vlen UA 02- 2014*”. Në këtë rast i lartpërmenduri tenton të interpretoj në mënyrë të njëanshme Dosjen e FDT.

1.6. Përkitazi me pohimet e OE Meditech, se sipas ligjit në fuqi dhe praktikës së AK, mos posedimi i Autorizim Marketingut nuk e lejon OE të caktuar që të shpërblehet me kontrate në një aktivitet të prokurimit” OE “Pharma Leader” deklaroi se, po ky Operator ka dy kontrata të lidhura me SHSKUK për produkte të ngjashme që përdoren për trajtimin e sëmundjes së njëjtë (por që kanë

ATC Code te ndryshme) me ç ‘rast: (a) Njërën produkt e ka me Autorizim Marketingu; kurse (b) Produktin tjetër ne vlere rreth 2 mil. € e importon ne baze te UA 02/2014;

1.7. Krahas deklarimeve si më sipër, OE “Pharma Leader” ka kërkuar nga OSHP të detyroj AK ta anuloj ose revokoj vendimin tani të atakuar, të marrë gjatë aktivitetit të prokurimit, përfshirë kushtet e paligjshme, ti shqiptoj gjobe për shkelje të vazhdueshme të LPP dhe te kërkoj revokimin e certifikatave për zyrtaret përgjegjës të AK., me arsyetimin se Vendimet OSHP janë detyruese.

2. Pohimet ankimore të OE “Meditech Sh.P.K”

2.1. OE “Meditech Sh.P.K” ka deklaruar se, kërkesa e OE Pharma Leader L.L.C. për të shitur barna të paregjistruara në Kosovë është kërcënim për jetën dhe shëndetin publik dhe e adresuar lidhur me këtë përgjegjësinë tek OSHP nën pohimin se, cituar: “Çka vendosni ju si panel në këtë rast, ka ndikim edhe në 3628 barna prodhuesit e të cilëve kanë respektuar ligjet e Kosovës, sigurinë e produkteve dhe i kanë regjistruar ato me Agjencionin e Produkteve Medicinale të Kosovës”.

2.2. “Meditech Sh.P.K” ka deklaruar se Autorizim Marketingu realisht konsiderohet si pasaportë e produktit, pasi që përcakton kontrollin e kualitetit, origjinën e tij, zinxhirin e ruajtjes dhe kujdesit nga prodhuesi deri tek pacienti, dhe mirëmbajtjen mbi efektet e barit, raportimet për efektet anësore dhe të ngjashme. Përmes Autorizim Marketing, përcaktohet edhe përgjegjësia, dhe sigurohet kualiteti i barnave. Pra, Autorizim Marketing ka Bashkimi Evropian, Amerika, dhe nuk ka asnjë shtet në botë për të cilin jemi në njohuri që lejon qarkullim të barnave pa Autorizim Marketing. Qeveria e Kosovës ka ndryshuar Udhëzimin Administrativ në fuqi ashtu që ka përshpejtuar procesin e regjistrimit për Autorizim Marketing.

2.2. Ligji Nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-047, në Nenin 16 të tij, paragrafin 1, shprehimisht përcakton që: “*Produkti medicinal mund të plasohet në Republikën e Kosovës vetëm pas marrjes së Autorizimit për Marketing nga AKPPM*”. I vetmi rast kur një produkt mund të importohet pa Autorizim Marketing është kur importi bëhet për nevoja personale siç është përcaktuar shprehimisht në nenin 12 të Ligjit të cituar. Mirëpo, në rastin konkret, duke qenë se insulinat importohen për nevoja të AK-së, institucion publik, rezulton se për insulina zbatohet neni 16, i cekur si më sipër. Po ashtu, duke qenë se produkti që është objekt i këtij aktiviteti të prokurimit veçse është i regjistruar, është e kundërligjshme që të lejohet importimi i një produkti të njëjtë por të paregjistruar. Nëse ky panel vendos të aprovojë kërkesën e Pharma Leader, atëherë duhet ti themi 3628 barnave tjera, mos i respektoni kërkesat e sigurisë në Kosovë dhe largoni regjistrimet.

2.3. AK, më datë 04.04.2022, ka mbajtur një takim konsultativ dhe ka ardhur në konkluzion se “*për furnizim me insulina kërkohet Autorizim Marketingu, për shkak se Ligji mbizotëron ndaj UA, për shkak të rëndësisë së produkteve, përgjegjësisë që ka bartësi i autorizim marketingut në rast se haset në telashe me një produkt*”. Përkundër të lartcekurave, në rastin konkret, eksperti

shqyrtues ka injoruar provën kryesore për këtë rast: qëndrimin institucional ndërmjet AKPPM-së dhe AK-së (Ministritë së Shëndetësisë) - të cekur si më sipër.

2.4. Çështje me shumë rëndësi që duhet ta kemi parasysh në këtë aktivitet të prokurimit është edhe fakti se për çështja e Autorizim Marketingut është gjykuar gjithsej 3 herë: 1 herë pranë OSHP-së dhe 2 herë pranë Agjencioneve të Kombeve të Bashkuara. Në OSHP nuk është vendosur në mënyrë meritore, por është rikthyer në rivlerësim si Ankesë pjesërisht e bazuar për të verifikuar thëniet e AKPPM. Kjo në një proces të dyshimtë, brenda 9 ditëve, duke mos u mbajtur fare seancë e as nuk janë respektuar afatet ligjore për komente në ekspertizë.

2.5. Eksperti ka theksuar se OE Meditech ka paraqitur Kërkesën për Rishqyrtim jashtë afatit ligjor. Kjo përkundër që AK ka marrë Vendim më datë 12.08.2022, ndërkaq OE në fjalë ka paraqitur Kërkesën për Rishqyrtim më datë 17.08.2022. Pra, rezulton se ditën e pranimit të vendimit Eksperti e ka kalkuluar si “dita 1”. Një vlerësim të tillë, në rastin konkret, Eksperti e ka marrë në kundërshtim me praktikën e krijuar nga vetë ai por edhe me aktet juridike në fuqi. Kështu, ndër të tjera, në rastet PSH 371/18, PSH 273/19, 295/19, dhe PSH 281/22, i njëjti Ekspert ka konstatuar se data e njoftimit, përkatësisht data e pranimit të vendimit/njoftimit, është “dita 0”. Dispozita e lartcekur qartëson faktin se data 12.08.2022, konsiderohet si dita 0, dhe se afati rrjedhë prej të nesërmës - pra, prej datës 13.08.2022. Nga data 13.08.2022 deri tek data 17.08.2022, ndërkaq, janë gjithsej 5 ditë. Rrjedhimisht, rezulton se OE Meditech ka paraqitur Kërkesën për Rishqyrtim brenda afatit, më saktësisht në ditën e 5-të.

2.6. Përmes Vendimit të datës 25.07.2022, OSHP ka qartësuar se ankesa e OE Pharma Leader L.L.C. është e pasafatshme. Një gjë e tillë i jep AK-së vetëm dy mundësi: (a) të nënshkruajë kontratën me OE Meditech SH.P.K.; ose (b) të anulohet në tërësi aktivitetin e prokurimit në fjalë. Duke qenë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore që të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit, rezulton se zgjidhja e vetme realisht është që AK të nënshkruajë kontratën me OE Meditech

2.7. Në rase se ju, si panel shqyrtues, lejoni importimin dhe plasimin e produkteve pa Autorizim Marketing. Gjithashtu, kjo do i thoshte 3628 barnave të regjistruar nga të gjithë prodhuesit tjerë, se nuk është e nevojshme të regjistrohen produkte të tilla dhe duhet larguar nga Kosova.

3. Pohimet e Autoritetit Kontraktues

3.1. Pas vendimit të OSHP Nr. 397/21 të datës 25.07.2022, MSH e ka anuluar aktivitetin e prokurimit sipas Vendimit të datës 12.08.2022 dhe ka shpallur aktivitetin e ri të prokurimit Nr. 206-22-9901-1-1-1 për të njëjtat produkte, duke konsideruar se anulimi i AP nga ana e MSh-se ka qenë në harmoni me vendimin e OSHP-se Nr. 397/21 të datës 25.07.2022. Duke i shpjeguar arsyet e anulimit dhe shpalljes së aktivitetit të ri prokurimit, AK mes tjerash ka shpjeguar:

- a. hapja e ofertave për këtë aktivitet është bere me 05.01.2021, ka kaluar kohe te gjate nga koha e tenderimit, kane ndërruar rrethanat, ka ndryshim te çmimeve te tregut;
- b. Anulimi i AP është i domosdoshëm edhe nga aspekti administrativ – ka defekte ne Dosje te Tenderit, duke shpjeguar në vijim:
- c. Përshkrimi i Çmimeve si pjese e FDT-se nuk është hartuar si duhet, sasia është përshkruar gabimisht: Sasia orientuese për 12 muaj, devijimi i lejuar +/- 30% .
- d. Ndërsa në DT tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD) është specifikuar se: “Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 24 muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi” d.m.th. kemi ndryshim brenda dokumenteve te njëjtit aktivitet,
- e. Të dy ofertuesit kane ofertuar sipas përshkrimit te çmimeve për 12 muaj dhe asnjeri nga OE nuk ka bere pyetje sqaruese për korrigjimin e këtij gabimi.
- f. Gjithashtu tek FTD neni 2.6 - Vlera e parashikuar, është specifikuar ne total 7,024,056.00 € (vlera e parashikuar e tri Lotëve për 24 muaj), nuk është përshkruar ndaras për çdo Lot.
- g. Këto defekte tek Përshkrimi i Çmimeve dhe tek Vlera e parashikuar ne DT, nuk mund te korrigjohet ne këtë faze, por konsiderojmë se janë arsye shume e madhe për anulimin e këtij aktiviteti, duke u bazuar ne nenin 62 te LPP-se.

3.2. Kërkesa e DT ka qene: 2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlen UA 02/2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës. Ky kriter ka qene i formuluar standard për te gjithë aktivitetet e barnave te Listës Esenciale dhe nuk ka dhënë alternative “kjo ose kjo” por me përjashtim te këtij rasti çdo është kuptuar qe kërkohet si primare AM, nëse nuk ka AM është dhënë mundësia me UA 02/2014.

3.3. Pas dilemave te shfaqura nga pretendimet ankimore gjate këtij aktiviteti është dhënë një Opinionin Ligjor sipas te cilit kriteri i dosjes së tenderit në parim është në funksion të zbatimit të Ligjit Nr.04/L-190 për Produktet dhe Pajisjet Medicinale, ku detyrimisht kërkohet regjistrimi i produkteve me Autorizim për Marketing ne Republikën e Kosovës.

Duke deklaruar në vijim se, Vendimi i OSHP për këtë lende ka ndikim direkt ne sigurinë e sistemit te furnizimit me insulina për mbi 15,000 diabetik qe i marrin Insulinat falas nga shteti, te cilët ne mungese te tyre u vështirësohet jeta (siç edhe ka ndodhe vitin e kaluar) dhe duke i propozuar Panelit që ta mbështes Vendimin e AK për anulimin e këtij aktiviteti, si vendim i drejtë qe mbron interesin publik, jetën dhe shëndetin e pacientit dhe ta kate parasysh nenin 104.4 te LPP-se, sipas të cilit: Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në

këtë Pjesë IX, OSHP duhet (iii) të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

OE "Pharma Leader" duke i kundërshtuar pohimet e OE "Meditech Sh.P.K" deklaroi se:
(1) OE "Meditech Sh.P.K" ka 2 kontrata aktive për 2 produkte nga i njëjti grup farmaceutik:
a) njeri produkt që ndihmon organizimin të prodhohet elktrocite është i regjistruar; kurse,
b) produkti tjetër është i pa regjistruar dhe importohet sipas UA 02/2014 që një vit;
c) I njëjti produkt nga një kompani tjera është i importuar mbi dy vite sipas UA 02/2014;
Prandaj (sipas OE "Pharma Leader") d.t.th. se, sipas OE "Meditech Sh.P.K" autorizim marketingu parashihet ose jo për një produkt, në varësi të interesit komercial të tij. Duke shpjeguar më tej se: Në vendet e BE produktet regjistrohen në Agjencionin Evropian sepse nuk mund të qarkullojë një produkt si i paregjistruar, kurse *produkti jonë* është i regjistruar në më shumë se 190 vende në EM. Prandaj autorizim marketingu nuk e mbulon cilësinë e produktit, por fakti i regjistrimit të tij.

OE "Meditech Sh.P.K": Ligji për produkte medicinale është i qartë dhe se pika 9.1 dhe 9.2 FTD është zbatuar vetëm kur nuk ka pas asnjë ofertë me autorizim marketing. Në momentin që regjistrohet një produkt me autorizim marketing nuk zbatohet importi paralel. Duke theksuar se, jam i skandalizuar me qëndrimin e ekspertit, sepse nuk është e pranueshme të citohet me email një paragraf edhe të mos merret qëndrim i përbashkët institucional, përndryshe pse kanë ardhë 3628 produkte edhe kompani si Pfaizer, Astrazeneka, Roshe me i regjistruar produkte në Kosovë, sepse importi pa paralele nuk është i aplikueshëm.

- *Mendimi i ekspertit shqyrtues* -

(a) OE "Pharma Leader" i ka plotësuar kriteret kualifikuese sipas 69 të LPP, meqë në dosje të tenderit parashihej, cituar: "Kërkohej regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar të produktit. Në rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlen UA 02/2014, Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës". Lidhur me këtë AKPPM, ka shpjeguar, cituar: "Produktet e ofruara nga OE "Pharma Leader" nuk kanë paralele dhe si të tilla mund të nënshtrohen UA Nr. 02/2014 Për thjeshtësim të procedurave për regjistrim dhe importim të produkteve medicinale pasi që e nuk janë produkte paralele".

(b) Kërkesa për Rishqyrtim e OE "Meditech Sh.P.K" e parashtruar në AK me datën 17.08.2022, ka qenë e jashtë-afatshme dhe e njëjta është shqyrtuar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP dhe nenit 4 të Rregullores për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim apo ankesave në OSHP, sepse:
- Njoftimi për vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit është publikuar me 12.08.2022; Ndërsa,
- Kërkesa për rishqyrtim e OE "Meditech" është parashtruar me 17.08.2022.

(c) Eksperti shqyrtues vlerëson se, me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet e parapara me depozitat e nenit 62 të LPP. AK ka theksuar se ka ndryshime të çmimeve në treg dhe ka bërë krahasim të çmimeve të ofruara nga OE "Meditech" me çmime të kontratave tjera, të cilat nuk dihet se në çfarë kushtesh apo rrethanash janë lidhur ato kontrata. Sipas ekspertit shqyrtues, AK nuk mund të marrë si pretekst për anulim të aktivitetit të prokurimit ndryshimet e çmimeve në treg përderisa OE pjesëmarrës kanë shprehur interesim për një aktivitet të prokurimit dhe qëndrojnë prapa ofertave çmimit e të cilave janë brenda buxheti të planifikuar.

(d) Prandaj me Vendimin e datës 25.03.2021, OSHP kishte kërkuar që aktiviteti i prokurimit të rivlerësohet sepse AK nuk i kishte respektuar kriteret kualifikuese sipas Vendimit të datës 05.03.2022, kurse vlerësimi i ofertave nuk ishte bërë në harmoni me nenin 59 të LPP. Megjithatë, AK me vendimin e datës 28.04.2021 sërish e ka rekomanduar OE "Meditech" oferta e të cilit është më e lartë në shumën prej 400.000,00 €. Fakti që AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së Nr.240/21, konsiderohet shkelje e nenit 105 të LPP.

(e) Kurse, Vendimi i OSHP i datës 12.07.2022, Nr.397/21, (sipas ekspertit) nuk e prejudikon rezultatin siç pohon OE "Meditech Sh.P.K" sepse me vendimin e cituar OSHP vetëm ka konfirmuar se ka kaluar afati i rregullt për shqyrtim e ankesave. Pavarësisht nga kjo, mos marrja për bazë e kriterëve të përcaktuara për kualifikim dhe kriterëve të përcaktuara për vlerësim gjatë rivlerësimit nënkupton se AK ka shkelur parimet bazë të LPP siç janë konkurrenca, transparencë dhe trajtimi i barabartë pasi që mos zbatimi i këtyre parimeve nënkupton favorizim-diskriminim të njërit palë në raport me palën tjetër.

Bazuar shkurtimisht në të lartëcekurat, eksperti ka rekomanduar se AK duhet ta anulojnë njoftimin e datës 12.08.2022 për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe të bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara për kualifikim dhe kriterin e përcaktuar për vlerësim, në pajtim me Vendimin e datës 25.03.2021.

- Konsatimet e Panelit Shqyrtues -

Pas shqyrtimit dhe administrimit të shkresave të kësaj lënde një nga një, duke i analizuar aktet dhe/ose veprimet e ndërmarra nga OSHP, AK, OE, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, deklarimeve të palëve në seancën e shqyrtimit kryesor dhe rekomandimeve ekspertit shqyrtues, Paneli Shqyrtues konsideron se:

Rrjedha e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret, karakterizohet apriori nga aktet dhe veprimet e AK, të cilat në raport me qëllimin e synuar të këtij prokurimi, nga pikëpamja e këtij Paneli, nuk janë implementuar me kujdesin e shtuar dhe në mënyrë profesionale sikurse kërkohet në kuptim

të nenit 1, të LPP (versioni i konsoliduar), sipas të cilit ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar, etike, duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji. Përveç kësaj, Paneli konsideron se në kontesktin integral të këtij Ligji, secili AK (i cilës do instancë) gëzon autonomi të plotë në procesin e prokurimit, në raport me identifikimin e nevojave me interes publik dhe planifikimit buxhetor. Nga ana tjetër, në kontesktin e disa pohimeve nga shkresat në dispozicion të kësaj lënde, duhet sikur mesazhet për *përgjegjësi* i drejtohen OSHP, i cili po ashtu në kuptimin intergral të këtij Ligji, i ushtron kompetencat, apriori nga momenti kur aktiviteti i prokurimit shndërrohet në një çështje kontesuese. Megjithatë në kontekstin e shkresave të kësaj Lënde, OSHP i udhëhequr nga parime etike dhe profesionale, ka tentuar ta ruaj integritetin institucional të AK dhe stabilitetin juridik në zbatim të këtij prokurimi, së paku në dy raste konkrete si në vijim:

1. Me Vendimin e datës 25.03.2021, OSHP ka kërkuar që AK ta rivlerësoj aktivitetin e prokurimit në kuptim të rrethanave të shpjeguara në këtë vendim (pa nevojë të përsëriten). Në këtë rast, është jokontesuese se AK nuk ka vepruar në harmoni me Vendimin e cituar, i cili në kuptim të legjislacionit nënkupton aktin administrativ të një organi kompetent, me efekte detyrues për të gjitha palët meqë i njëjti buron nga normat kogente të LPP dhe kompetencat e OSHP, nga cilësia e tij si organ i administratës shtetërore në shkallë të dytë. Paneli konsideron (pa ndonjë paragjykim) se, përfillja e Vendimit të cituar do evitonte në kohë efektive çdo dilemë, në relacion me kriteret e paraparë, për s'arsye furnizimi me ilaçin konkret, sipas fakteve dhe rrethanave të përshkruara si në hyrje të këtij vendimi, pa nevojë ka marrë karakter *dramatik*.

2. Kurse, me Vendimin e datës 12.07.2022, OSHP ka marrë Vendimin Nr. 397/21, e ka lenë në diskrecionin e plotë të AK-MSH, menaxhimin e këtij aktivitetit të prokurimit (për shkak të mungesë së Bordit në një kuadër të konsiderueshëm kohor), por natyrisht pa e mohuar Vendimin e cituar si më sipër të po këtij organi.

Prandaj, bazuar shkurtimisht në dy faktet e cituara si më sipër, ky Panel konsideron se anulimi i tenderit nga ana e AK me Vendimin e datës 12.08.2022, është bërë në kundërshtim me dispozitat e LPP, së paku për faktin parimor se përderisa Vendimet e OSHP bëjnë në juridiksionin e LPP, të njëjtat në kontekstin e nenit 1, të këtij Ligji përfshihen dhe nënkuptojnë, cituar: "...kushte dhe rregulla që do të zbatohen, procedura që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen..." Nga ana tjetër, bazuar në shkresat e kësaj Lënde, OSHP vëren se Udhëzimi Administrativ Nr.2/2014, përbën çështje kyçe gjatë tërë rrjedhës së këtij prokurimi, lidhur me faktin se kur dhe/ose në cilat rrethana, i njëjti gjen zbatim. Nga ky aspekt, Paneli mendon se AK nuk i ka plasuar gjer në shkallë të duhur në opinionin publik, informatat relevante për këtë UA, për t'i evituar dilemat eventuale lidhur me këtë, meqë ka kapacitet profesional të paktën nisur nga misioni i AK edhe meqë Udhëzimi Administrativ në rastin konkret daton nga viti 2014, kurse aktiviteti i prokurimit është iniciuar me Njoftimin për kontratë me 12.12.2020. D.m.th. 6 vite pas miratimit të UA dhe pothuajse 2 vite nga tani retroaktivisht.

Në këtë rast, pavarësisht opinionit të palëve, Paneli mendon se interpretimi dhe/ose vlerësimi i dispozitave të akteve nënligjore, në raport me ligjet përkatëse të një AK, nuk bijnë nën jurisdikcionin e OSHP. Ekzistimi i këtij UA, përbën për këtë Panel një çështje faktike, normat e të cilit kanë karakter kogent dhe është fakt notor se i njëjti përderisa të jetë në fuqi, konsiderohet pjesë e legjislacionit relevant, harmonizimi dhe/ose vlefshmëria e normave të t 'cilit të cilit nuk konstatohet brenda jurisdiksikonit të LPP dhe OSHP.

Përmbajtja e këtij UA karakterizohet me dispozita me karakter specifik, të dedikuara pikërisht për aktivitetin e caktuar të prokurimit, me ç 'rast termat, nocionet dhe/pse përkufizimet e tij dedikohen pikërisht për qëllime furnizimi dhe si të tilla janë vendosur në dosjen e tenderit. Kurse, emërtimi i tij, për cdo subjekt me interes ofron porosi se apriori ky UA nënkupton thjeshtësimin e procedurave të furnizimit (jo komplikimin). Prandaj Paneli konsideron se është krijuar pa nevojë një abiguitet (dykuptimësi) i cili objektivisht ka ushtruar ndikim në tërë rrjedhën e prokurimit. Në vështrim të shkresave të kësaj lënde Paneli vëren se (brenda AK) dominojnë dy mendime nga të cilat janë krijuar dy veprime paralele për të njëjtin aktivitet. Mes këtyre dy opinionëve, Paneli ja fal besimin Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), entitet kompetent brenda AK, ka shpjeguar se, cituar (korrespondenca brenda AK e datës 03.02.2021 dhe 05.02.2021):

- Ju lejohet importi i produktit me ATC Code A10AB04 dhe A10AD04, në bazë të UA 2/2014, pasi që ndryshon niveli i fundit i kodit ATC me produktet që janë të regjistruara”
- “Nëse ATC Code i këtij produkti në nivelin e pastë të kodit të tijë ndryshon me produktin medicinal që ka AM, ju lejohet importi i tij në Kosovë, sipas UA 2/2014”

Paneli mori megjithatë në konsideratë dhe një Opinion Ligjor, të hartuar për nevojat e AK i cili komenton për harmoninë ose jo, të dispozitave të këtij UA raport me Ligjin për pajisje dhe produkte medicinale. Paneli mendon se, edhe nëse do të nisej nga supozimi se ky opinion përmban një leksion profesional, megjithatë ngel opinion, kurse mbetet në diskrecionin e AK që UA në rastin konkret ta lerë në fuqi, ta revokoj apo ta inicioj procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë së tij. Paneli konsideron se, me sa duket Opinioni i cituar ka krijuar efekte në AK për anulimin e tenderit edhe përkundër faktit se theksohet “ky opinion paraqet bindjen personale sipas hulumtimit dhe analizës ligjore dhe nuk prezanton domosdo qëndrimin e MSH apo DL”. Paneli konsideron se, në praktikën institucionale opinionet e tilla kanë karakter udhe rrëfimi apo këshille por nuk krijojnë efekte në veprimet institucionale. Kurse, veprimet e cdo institucioni janë veprime me karakter administrativ dhe përfundojnë me akt administrativ, i cili bazohet në normat e karakterit legjislativ (jo në opinione). Pavarësisht se opinionet e tilla mund të burojnë nga organizata të ndryshme (ndërkombëtare), megjithatë sovraniteti i një vendi (në emërin e të cilit secili dikaster ushtron nga pjesë të kompetencave shtetërore) ushtrohet mbi bazën e ligjeve. Prandaj Paneli konsideron se:

- Opinioni në rastin konkret nuk mbisundon mbi normat kogente të UD Nr. 2/2014;

- Përdorimi i Opinionit për të krijuar, modifikuar ose ndërruar specifika teknike në një Dosje të Tenderit, nga aspekti i kundërt nga ajo çfarë parasheh një UA, e shndërron aktivitetin e prokurimit në veprim të paligjshëm administrativ (me karakter të nulitetit absolut);

Prandaj për mendimin e këtij Paneli, shmangja nga aplikimi i këtij UA nënkupton shmangje nga nga UA, dhe kjo rezulton me faktin që DT të krijohet me specifika teknike paraprakisht të caktuara. Në kuptim të natyrës së kësaj çështje, kjo qasje e AK paraprakisht i eliminon OE tjerë, pa nevojë për vlerësimin e ofertave. Nëse për Panelin do të pranohej kjo qasje e prokurimit, atëherë qasja e OSHP do të kualifikohej si veprim në kundërshtim me nenin 7 të LPP, sipas të cilit: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik” pa i cituar një varg dispozitash tjera të cilat në kontekstin integral të LPP, sanksionojnë konkurrencën dhe parimet e tregut liberal.

Nga faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, nga deklaratimet e palëve dhe nga shkresat e kësaj lënde, sipas këtij Paneli e paraqesin objektivisht: Të njëjtin aktivitet të prokurimit, për të njëjtin AK, për të njëjtin qëllim dhe të njëjtin produkt; me një dosje të tenderit, por me dy zgjidhje kontradiktore dhe dy sisteme paralele të prokurimit:

E para: Me datë 22.02.2021, AK ka publikuar Vendimin sipas të cilit:

- “Pharma Leader” LLC është OE i rekomanduar për kontratë për Lot I me vlerën e ofertës 1,097,467.36 E dhe Lot III, me vlerën ofertës 4,109,006.12 E. Kurse,
- “Meditech” OE i rekomanduar për kontratë për Lot II, me vlerën e ofertës 913,315.00 E

E dyta: Me datë 05.03.2021, për të njëjtin aktivitet të prokurimit, me kriteret e njëjtë në Dosjen e Tenderit, AK e ka rekomanduar për kontratë (përfshirë dhe dy lotet tjera):

- OE “Meditech Sh.P.K”

Kurse OE “Pharma Leader” LLC se është eliminuar, për arsytet si në vijim:

- Kërkohej regjistrimi i barit – autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar të produktit. Në rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlen UA 2/2014 për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës.

Nga shkresat e kësaj lënde konstatohet se në vazhdimësi, janë ndërmarrë një serë veprimesh nga palët (OE “Pharma Leader” LLC) edhe AK, deri me datën 27.04.2021, kur AK i ka komunikuar rezultatet e këtij prokurimi. Në ky aspekt Paneli konsideron se AK nuk e ka përfillur Vendimin e OSHP të datës 25.03.2021, sipas të cilit OSHP ka kërkuar që për shkaqet e cituara AK ta rivlerësoj aktivitetin e prokurimit. Kjo qasje e AK, për mendimin e këtij Paneli bje në kundërshtim me:

- Me nenin 105 (Kompetencat e OSHP) lidhur me nenin 131 të LPP.
- Me nenin 51 të LPP sipas të cilit, AK duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes. Dhe serish nga këndvështrimi i këtij Paneli, do të thotë se përderisa të njëjtët kriter formal kanë figuruar të

publikuar, AK ka aplikuar praktikisht kriter tjerë të përzgjedhjes (në raport me DT) duke e bere rrjedhën e prokurimit inkompatibile me kushtet formale të publikuara të këtij aktivitetit të prokurimit. Paneli konsideron se shpallja e tenderit dhe anulimi i të njëjtit, për arsyet e theksuara në Vendimin tani të atakuar të AK, bje ndesh me *synimet institucionale* siç parashikohet me nenin 9 të LPP.

Paneli Shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 62, duke renë ndesh në mënyrë specifike me paragrafët 2.1 dhe 2.2, dhe nga ky aspekt konstatimet e ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe rekomandimet e tij, Paneli i mori për bazë dhe konsideron se nuk ka shkelje të nenit 7 të LPP (siç është shpjeguar më sipër) dhe nuk ka bazë që procesi i tenderimit të përfundoj sipas nenit 62. paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. i LPP, sepse në nenin 62, të LPP thuhet mes tjerash se AK mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës për një të njërit nga arsyet:

- Të gjithë tenderët përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues - gjë që kjo nuk ka ndodhur;
- Për shkak të ngjarjeve objektive dhe arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të prokurimit - gjë që as kjo nuk ka ndodhur;
- AK nuk mund ti marr si pretekst për anulim të aktivitet të prokurimit ndryshimet e çmimeve në treg përderisa OE kanë shprehur interesim për një aktivitet te prokurimit dhe qëndrojnë prapa ofertave çmimet e të cilave janë brenda buxhetit të planifikuar;
- Vendimi i OSHP i datës 12.07.2022, Nr.397/21, nuk e prejudikon rezultatin e tenderit dhe nuk e mbisundon dispozitën e nenit 62, të LPP dhe njëherësh nuk përbën bazë për anulimin e aktivitetit të prokurimit ngase nuk janë përmbushur kushtet e parashikuara në pikat 2.1 dhe 2.2, të paragrafit 2, të nenit 62 të LPP.
- Mos marrja për bazë e kriterëve të përcaktuara për kualifikim dhe kriterëve të përcaktuara për vlerësim gjatë rivlerësimit, nënkupton se AK ka shkelur parimet bazë të LPP siç janë ekonomiciteti dhe efikasiteti, konkurrenca, transparenca dhe trajtimi i barabarte pasi qe mos zbatimi i këtyre parimeve nënkupton favorizim-diskriminim të njërit palë në raport me palën tjetër duke vepruar në kundërshtim me paragrafin 1, të nenit 6, të LPP;

Lidhur me Ankesën e OE Meditech Sh.P.K. Paneli mori në konsideratë konstatimin e Ekspertit shqyrtues sipas të cilit Kërkesa për rishqyrtim e OE në rastin konkret, ishte ushtruar jashtë afatit ligjor dhe e njëjta është shqyrtuar nga AK në kundërshtim me pikën 3.3, të paragrafit 3, të nenit 108/A të LPP, lidhur me pikën c. të nenit 4, të “Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave”. Prandaj lidhur me ankesën e OE Meditech Sh.P.K. Ky panel vendosi si në pikën 2, të dispozitivit të këtij Vendimi. Paneli Shqyrtues i analizoj me kujdes të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi lidhur me llogaritjen e afateve për ti evituar të gjitha dilemat eventuale në raport me pohimet ankimore të parashtruesit në rastin konkret. Megjithatë ky Panel konsideron se OSHP duhet ta zbatoj me përpikëri ligjin në fuqi të prokurimit publik (versioni i konsoliduar), nga

i cili buron dhe mandati i këtij organi. Nga ky aspekt Paneli konsideron se pavarësisht opinioneve të ndryshme, sado qofshin ato kontradiktore apo të bazuara, këtë Panel e detyron dispozita e nenit 108/A të LPP e cila në paragrafin 3 pika 3.3 gjenë zbatim për çështjen në rastin konkret, sepse i referohet në mënyrë shprehimore vendimit të AK për anulim. Në citimin e tij ky paragraf thotë cituar “Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për anulimin e procesit të prokurimit brenda pesë (5) ditëve nga dita kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim”. Kjo do të thotë se rrjedha e afatit në raport me ankesën e parashtruesit Meditech, fillon efektivisht nga dita kur vendimi është anuluar zyrtarisht. Duke mos precizuar dhe/ose shpjeguar asnjë veprim tjetër të organit apo të palëve, prandaj sipas kësaj dispozite afati rrjedhë nga dita kur është vendosur zyrtarisht. Paneli shpreh mendimin e tij se kjo dispozitë e obligon pa ndonjë alternativë. Në këtë kuptim Paneli konsideron se Kërkesa e parashtruesit Meditech duhet të trajtohet se është paraqitur pas skadimit të afatit siq precizohet në pikën c, të paragrafit 4.1 të rregullorës së cituar më sipër, e cila është kompatible me paragrafin 3.3 të nenit 108/A të LPP. Meqë në rastin konkret vendimi i AK është publikuar në të njëjtën ditë kjo do të thotë se AK e ka përmbushur detyrimin në kuptim të paragrafit 4.2 të nenit 4 të rregullores..” “Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim,..” e që në llogaritjen e afatit në këtë rast dita e njoftimit llogaritet si ditë brenda afatit të paraparë, e jo si dita “zero”.

Paneli po ashtu mori vendim:

- Që të shqiptohet gjoba në të holla për Autoritetin Kontraktues në lartësi të shumë 5.000,00 €, për shkak të mosrespektimit të Vendimit të OSHP të datës 25.03.2021, në pajtim me nenin 131, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;

-Të Inicohet procedura për revokimin e certifikatës së prokurimit kundër zyrtarit përgjegjës të prokurimit të AK, për shkak të shkeljeve të dispozitës së nenit 25, paragrafi 8, të LPP;

Të lejohet kthimi i tarifës për ankesë për OE “Pharma Lider” ShPK, dhe për OE “Meditech” ShPK sipas nenit 31, paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP, Nr.1/20, datë 03.03.2020;

- *Përfundim* -

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore. Mirëpo, Paneli shqyrtues konsideron se ndërmarra e veprimeve për iniciimin e prokurimit dhe me pas anulimi i të njëjtit dhe aplikimi i kritereve të dyfishta, bije ndesh me nocionet, parimet dhe institutet themelore të LPP. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e

interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Nisur nga të lartcekurat Paneli Shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, ne pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryetare e Panelit Shqyrtues
Znj. Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet me Padi, Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- 1x1 AK – MSH
- 1x1 OE “Pharma Leader”
- 1x1 OE “Meditech Sh.P.K”
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;